


PËRFAQËSIMI I PAKICËS KOMBËTARE SHQIPTARE NË MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME TË SERBISË: PROGRESI DHE SFIDAT



Belgrade Centre for Security Policy



Kosovar Center for Security Studies

**Përfaqësimi i pakicës
kombëtare shqiptare në
Ministrinë e Punëve të
Brendshme të Serbisë:
Progresi dhe sfidat**

Prishtina dhe Beogradi
2014

Botuesit:

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
[QKSS] dhe
Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë
[QBPS]

Autore:

Sofije Kryeziu
[Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë]

Bashkëautore:

Isidora Stakiq
[Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë]

Redaktore:

Sonja Stojanović Gajić

Përkthyes:

Valdete Osmani

Redaktor:

Naile Mala Imami

Dizajni dhe Faqosja:

Marko Marinković

ISBN 978-86-6237-090-7

Prishtina dhe Beogradi, 2014

© BCBP dhe KCSS

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

CIP - Каталогизација у публикацији
Народна библиотека Србије, Београд

351.741(497.11)"20"
323.1(=18)(497.11)"20"
351.86(497.11)"20"

KRYEZIU, Sofije, 1988-
Përfaqësimi i pakicës kombëtare shqiptare
në Ministrinë e Punëve të Brendshmetë
Serbisë : progresi dhe sfidat / [autore
Sofije Kryeziu ; bashkëautore Isidora
Stakiq]. - Prishtinë : Qendra për Studime të
Sigurisë në Prishtinë (QKSS) ; Beogradi :
Qendre për Politikë të Sigurisë në Beograd
(QBPS), 2014 (Beograd : Unigraf). - 20 str. ;
30 cm

Tirazh 300. - Napomene i bibliografske
reference uz tekst. - Bibliografija: str.
17-19.

ISBN 978-86-6237-090-7

1. Stakić, Isidora [аутор]

a) Полиција - Организација - Србија - 21в

b) Албанско питање - Србија - 21в с)

Безбедности сектор - Србија - 21в

COBISS.SR-ID 210497036

Botimi i këtij dokumenti hulumtues është mbështetur nga Trusti Ballkanik për Demokraci, Programi profesional i shkëmbimit të punës për nxitje të dialogut për zhvillim të politikave, nga Zyra e Mbretërisë së Bashkuar për Çështjet e Jashtme dhe të Komonveltit. Ky botim është krijuar në kuadër të projektit 'Forumi për hulumtimin e sigurisë: Beogradi-Prishtina-Tirana' të cilin e ka mbështetur Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë.

Pikëpamjet dhe analizat e përmbajtura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk paraqesin domosdo pikëpamjet e qeverive norvegjeze dhe britanike ose të degëve të tyre.

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Që nga fundi i konflikteve në tri komuna të Serbisë Jugore në vitin 2001, është arritur përparim i rëndësishëm për ngritjen e përfaqësimit të popullatës shqiptare në policinë vendore. Ky përparim ka ngecur kohëve të fundit. Interesimi për inkuadrimin në forcat policore nga pakica kombëtare shqiptare është rritur posaçërisht nga fundi i konfliktit në vitin 2001 në territorin e komunës së Preshevës, të Bujanocit dhe të Medvegjës. Sukses i arritur në krijimin e policisë shumëkombëshe pas konfliktit ka rezultuar që shqiptarët të kenë besim në polici më shumë se sa në ndonjë institucion tjetër të sigurisë në Serbi, madje besimi është më i madh se sa nga ana e shumicës etnike serbe. Banorët e këtij rajoni i besojnë policisë në numër të madh, më saktësisht 33% e të anketuarëve i besojnë policisë në krahasim me banorët në vende të tjera të Serbisë ku vetëm 19% nga numri i përgjithshëm i të anketuarëve ka mendim të njëjtë [BCSP, 2013]. Motivi kryesor për hyrjen e shqiptarëve në polici është punësimi.

Megjithatë, ka nevojë për të punuar edhe më tutje në integrim sepse ende ka mospërputhje mes përfaqësimit të shqiptarëve në popullsi dhe në strukturat policore. Deri tani sukses është arritur në rritjen e përfaqësimit të pakicës etnike shqiptare në nivelet e ulëta të njësive policore të Preshevës dhe të Bujanocit. Në Preshevë 50.4% e policëve janë shqiptarë kurse përqindja e popullsisë shqiptare është 89%, në Bujanoc 35% e policëve janë shqiptarë kurse përqindja e popullsisë shqiptare është 55% , dhe vetëm 5% policë shqiptarë janë të punësuar në Medvegjë kurse 26% e popullsisë janë shqiptarë [Halimi, 27.02.2014]. Sidoqoftë, numri i ulët i përfaqësimit të pakicës etnike shqiptare mbetet i pranishëm në nivelet dhe në pozitat e larta policore. Kur është fjala për strukturën rajonale policore, përfaqësimi i shqiptarëve gati nuk ekziston, vetëm një polic shqiptar punon në Drejtorinë rajonale policore në qytetin e Vranjës.

Sfidat kryesore të përfaqësimit të shqiptarëve në polici janë: çështjet politike, organizimi i

policisë dhe distancimi shoqëror nga shumica etnike. Grupi i parë i sfidave reflektohet në mungesë të vullnetit politik të autoriteteve të Serbisë për të punuar në integrimin e plotë të pakicës etnike shqiptare në të gjitha nivelet e strukturave publike, e cila është e dukshme në progresin e ngadalësuar të njohjes së diplomave të Universiteteve të Kosovës [ku shumica e policëve shqiptarë janë edukuar] si dhe kufizimet praktike në përdorimin e gjuhës amtare në komunat me banorë shumicë shqiptarë. Grupi i dytë i sfidave ka të bëjë me politikën joadekuate të llojllojshmërisë brenda policisë e cila vërehet në paqëndrueshmëri të qasjes në edukimin policor dhe në pengesat e integritit në mjedisin shoqëror. Integrimi i plotë dhe i qëndrueshëm në polici në tri komunat e jugut të Serbisë është me sfida edhe për shkak të paragjyqimeve në Serbi për pakicën etnike shqiptare. Prandaj, njëra nga rekomandimet kryesore është që të sigurohet inkuadrimi i qëndrueshëm i pakicës kombëtare shqiptare në policinë e Serbisë duke siguruar që përfaqësimi i shqiptarëve të pasqyrojë përbërjen e popullsisë.

HYRJA

Qëllim kryesor i këtij botimi që nga fillimi është që të vlerësohet përfaqësimi i pakicës etnike shqiptare në institucionet e sigurisë së Serbisë siç janë policia, ushtria dhe xhandarmëria. Në bazë të analizës së dokumenteve dhe literaturës është zbuluar se përfaqësimi i pakicës kombëtare shqiptare në ushtri dhe xhandarmëri nuk ekziston, prandaj në këtë botim jemi përqendruar vetëm në përfaqësimin në polici. Pakica kombëtare shqiptare në territor të shtetit të Serbisë është e përqendruar në tri komuna të jugut të Serbisë: Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, prandaj ky botim do t'i kushtojë vëmendje të posaçme vlerësimit në përfaqësimin e shqiptarëve në njësitë policore në këto tri komuna. Botimi ofron edhe rekomandime të cilat u dedikohen autoriteteve qendrore me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të përfaqësimit të pakicës kombëtare shqiptare në policinë e Serbisë. Analiza e integritit është bazuar te standardet e pranuar ndërkombë-

tare që kanë të bëjnë me: miratimin e politikave të qarta të organeve të sigurisë për promovimin e pakicave kombëtare në nivel kombëtar dhe vendor; promovimin e rëndësisë së marrëdhënieve ndëretnike që duhen zbatuar nga organet shtetërore dhe policore; zhvillimin e planeve të veprimit për realizimin e këtyre politikave si dhe vëzhgimin e rregullt të realizimit të tyre; përbërjen e policisë në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar duke përfshirë pozitat e larta dhe të ulëta, si dhe përbërjen e nëpunësve civilë që duhet të reflektojë diversitetin e popullsisë (OSBE, 2006: 4). Gjithashtu, për t'i zgjidhur çështjet e natyrës operative siç është përdorimi i gjuhës amtare në edukim/trajnim/zhvillim profesional, zhvillimet në të gjitha fushat kanë ngecur përkundrazi faktit se ekzistojnë rekomandimet që këto çështje të trajtohen në mënyrë të duhur. Huluntimi ka zbuluar që përveç rritjes së numrit të shqiptarëve në stacionet policore në këto tri komuna, progresi i mëtutjeshëm që do të siguronte inkuadrimin e qëndrueshëm të minoriteteve, përdorimin e gjuhës, zhvillimin e karrierës dhe mundësisë të njëjta për përparim nuk është siguruar në mënyrë të plotë.

METODOLOGJIA

Këtë botim e kanë përgatitur dy organizata këshillëdhënëse/think tank-e të pavarura nga Prishtina dhe Beogradi duke pasur si qëllim zbulimin e progresit dhe sfidat në të cilat kanë hasur gjatë integritit të pakicës etnike shqiptare në polici të Serbisë. Ne besojmë se është më rëndësi që përmes bashkëpunimit të ofrohen analizat të cilat mundësojnë qasje kritike dhe verifikim të të dhënave duke u bazuar në interesimin e publikut nga Kosova dhe Serbia. Për zhvillim të këtij botimi, autorët i kanë analizuar dokumentet dhe kanë zhvilluar 20 intervista me partnerët në Beograd, Preshevë, Bujanoc dhe në Vranjë në fund të shkurtit dhe në fillim të marsit të vitit 2014. Intervistat janë zhvilluar me përfaqësuesit e autoriteteve shtetërore të Serbisë, organizatat joqeveritare si dhe me gjashtë policë shqiptarë nga Presheva dhe Bujanoci. Duhet përmendur se autorët e huluntimit kanë

hasur në sfida për të mbledhur të dhëna të sakta statistikore rreth përfaqësimit nga Ministria e Punëve të Brendshme pasi që Ministria nuk kërkon nga personeli të deklarohen rreth nacionalitetit të tyre.¹ Prandaj, statistika për përfaqësim të shqiptarëve në policinë e Serbisë është marrë nga Këshilli i Pakicës Shqiptare dhe aktorëve tjerë në nivelin lokal në tri komuna.

KORNIZA LIGJORE PËR PJESËMARRJE TË PAKICAVE NË ÇËSHTJE PUBLIKE

Mekanizmat ndërkombëtarë

Pjesëmarrja e pjesëtarëve të pakicave etnike në punët publike në shtet në të cilin jetojnë është kyçe për mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe për parandalimin e përjashtimit shtetëror. Prandaj është e garantuar me instrumentet e Kombeve të Bashkuara (UN), Këshillit të Evropës (CoE) dhe Bashkimit Evropian (EU).² Instrumentet kryesore për të drejtat e njeriut i mbrojnë të drejtat e pakicave, në vend të parë me parimin e mosdiskriminimit i cili krijon bazë të domosdoshme për mbrojtjen e pakicave. Megjithatë, dispozita e mosdis-

1 Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë, Kabineti i ministrit, Zyra për informata me rëndësi publike, 01 no.: 1586/14, "Duke marrë parasysh që korniza ligjore dhe kushtetuese nuk e obligon askënd të deklarojë kombësinë, Ministria nuk ka mbledhur të dhëna për përkatësinë etnike të të punësuarëve të saj", 21 shkurt 2014

2 Për shembull, neni 2 i *Deklaratës së Kombeve të Bashkuara për Pakicë* e vitit 1992 ofron bazë për të drejtat e personave të pakicave për pjesëmarrje efektive në jetën kulturore, fetare, shoqërore, ekonomike dhe publike si dhe në marrjen e vendimeve në nivel vendor dhe kombëtar për çështjet që kanë të bëjnë me pakicën të cilës i takojnë. *Konventa Korniza e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare* nga viti 1995 e përforcon këtë dispozitë duke i obliguar palët të krijojnë kushte të nevojshme për pjesëmarrjen efektive të personave që u përkasin pakicave kombëtare në jetën kulturore, shoqërore dhe ekonomike dhe në çështjet publike, posaçërisht në çështjet të cilat kanë të bëjnë me jetën e tyre. Neni 2 i *Traktatit të Bashkimit Evropian* shfaq respekt për të drejtat e njeriut duke i përfshirë të drejtat e pjesëtarëve të minoriteteve etnike si një nga vlerat bazë të Bashkimit. Përkushtimi i BE për të drejtat e pakicave më vonë është zhvilluar me përfshirjen e parimit të mosdiskriminimit në *Traktatin e Amsterdimit* të vitit 1997 me themelimin e Komitetit për të Drejtat e Njeriut dhe Demokraci në vitin 1999 dhe me miratimin e *Kartës për të Drejtat Fundamentale* të vitit 2000.

kriminimit e cila i detyron shtetet që t'i braktisin të gjitha ligjet dhe masat diskriminuese ndaj grupeve të posaçme, nuk mjafton për të siguruar barazi të qëndrueshme. Prandaj, autoritetet shtetërore duhet të ndërmarrin masa pozitive, me fjalë tjera masa afirmative me anë të së cilave grupi i minoriteteve do të favorizohet me qëllim të eliminimit të dallimit mes grupeve të cilat kanë përparësi dhe atyre që nuk kanë. Nevoja për masa afirmative bëhet posaçërisht urgjente në shoqëritë të cilat në të kaluarën e afërt kanë qenë të prekura nga konfliktet etnike. Në këto shoqëri, ri-ndërtimi i besimit mes grupeve të ndryshme etnike është i pamundur pa përfshirjen e minoriteteve etnike në punët publike dhe në proceset e vendimmarrjes.

Konteksti ligjor në Serbi

Duke i marrë parasysh mekanizmat ndërkombëtarë dhe kornizën ligjore të Serbisë del se legjislacioni në Serbi për mbrojtjen e pakicave është në pajtim me standardet ndërkombëtare në nivel të volitshëm, posaçërisht me Ligjin për Ndalimin e Diskriminimit të vitit 2009 [Gazeta Zyrtare e RS, Nr. 22/2009]. Dispozita për mosdiskriminim është e përfshirë në të gjitha ligjet kryesore duke përfshirë Kushtetutën dhe mund të thuhet se nuk ka pengesa ligjore që pjesëtarët e minoriteteve të punësohen dhe të zhvillojnë karrierën në institucionet e sektorit publik. Megjithatë, kur është fjala për masat dhe veprimet afirmative situata është më pak e mirë. Masat e politikave të cilat kanë për qëllim të sigurojnë barazinë e plotë dhe efektive janë të përcaktuara me disa ligje tjera por jo edhe me ligjet të cilat e rregullojnë punën e sektorit të sigurisë. Vendosja e një dispozite të tillë në legjislacion të sektorit të sigurisë nuk është e obligueshme por mund të demonstrojë dëshirën për të punuar në zgjidhjen e trashëgimisë së konflikteve gjatë të cilave disa minoritete etnike kanë qenë të përjashtuara nga institucionet e sigurisë. Institucionet e sektorit të sigurisë së Ballkanit Perëndimor kanë qenë të përfshira në konfliktet etnike në të kaluarën e afërt dhe si të tilla kanë një imazh posaçërisht negativ ndër anëtarët e pakicave etnike.

Në Serbi përfaqësimi i minoriteteve në institucionet publike është i garantuar me Kushtetutë. Përveç nenit 21 të Kushtetutës e cila e përmban dispozitën e përgjithshme për mosdiskriminim, pjesa e tërë Kushtetutës [nenet 75-81] i përkushtohet mbrojtjes së pakicave kombëtare [Kuvendi Kombëtar i RS, 2006]. Pra, neni 76 ndalon çdo diskriminim në bazë të etnicitetit dhe në mënyrë të hapur i parashikon masat afirmative. Më tutje, neni 53 e përcakton që të gjithë qytetarët, nën kushtet e barabarta, të kenë të drejtë të marrin pjesë në punët e qeverisë dhe të marrin pozita në institucione publike, kurse neni 77 e rikonfirmon këtë parim duke iu referuar posaçërisht pakicave etnike të cilat e gëzojnë këtë të drejtë. Në fund, neni 60 i Kushtetutës së Serbisë e përcakton që të gjitha vendet e punës duhet të jenë të hapura për të gjithë qytetarët sipas kushteve të njëjta.

Përveç Kushtetutës, dispozitat të cilat i mbrojnë të drejtat e pakicave janë të përfshira në ligje të ndryshme, ndër të cilat më i rëndësishëm është Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Pakicave Etnike nga viti 2002 i cili, mes të tjerash, i shpjegon disa nga dispozitat e Kushtetutës të përmendura në tekstin e mësipërm, duke i inkurajuar veprimet afirmative të autoriteteve shtetërore [Gazeta Zyrtare e RFJ, Nr. 11/2002]. Më tutje, neni 9 i Ligjit për Punonjësit Civilë nga viti 2005 thekson se për punësim të punonjësve civilë, kujdes i posaçëm duhet t'i kushtohet përfaqësimit të minoriteteve që do të pasqyrojë në mënyrë adekuate përbërjen e shoqërisë [Gazeta Zyrtare e RS, Nr. 79/2005]. Në fund, në vitin 2009 Kuvendi i Serbisë e ka miratuar Ligjin e parë gjithëpërfshirës për mosdiskriminim i cili ka krijuar mekanizëm të ri institucional – Komisionerin për Mbrojtjen e Barazisë – organ i pavarur me mandate të për të parandaluar të gjitha format e diskriminimit si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të normave antidiskriminuese [Gazeta Zyrtare e RS, Nr. 22/2009].

Kur është fjala për sektorin e sigurisë në Serbi, kushtet dhe kriteret për punësim janë të përkufizuara me ligje të cilat i rregullojnë punët e institucioneve në sektorin e sigurisë,

siç është Ligji për Polici i vitit 2005, Ligji për Mbrojtje i vitit 2007, Ligji për Ushtri i vitit 2007, dhe Ligji për Agjenci të Inteligjencës dhe Sigurisë i vitit 2002. Dispozitat që gjenden në këto ligje janë neutrale rreth etnicitetit që do të thotë se kushtet dhe kriteret për praninë në polici vlejné në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët pa marrë parasysh nëse i përkasin pakicës ose shumicës etnike [Bjelosh, 2012: 253]. Ligjet për institucionet e sigurisë nuk kërkojnë në mënyrë specifike as nuk e inkurajojnë përfaqësimin proporcional të minoriteteve etnike në sektorin e sigurisë (Ibid).

Megjithëkëtë, Komisioneri për Mbrojtjen e Barazisë, në pajtim me mandatin statusor të dhënies së rekomandimeve autoriteteve publike për masat e avancimit të barazisë e ka rekomanduar në vitin 2011 Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) që të ndërmarrë masa adekuate për të siguruar se përbërja e njësisve rajonale policore është në pajtim me përbërjen etnike të rajonit në të cilin policia i kryen detyrat e veta [Komisioneri për Mbrojtjen e Barazisë, 312/2011]. Në këtë rast, Komisioneri ka vepruar në bazë të ankesës kundër MPB-së për diskriminim të supozuar ndaj anëtarit të pakicës etnike boshnjake të pajisur me diplomë të Sarajevës, Bosnja dhe Hercegovina. Mendimi i Komisionerit ishte se MPB-ja nuk i ka diskriminuar boshnjakët, por që ka hapësirë për përmirësimin e përfaqësimit të pakicës etnike boshnjake në polici. Edhe pse ky rast ka të bëjë me pakicën boshnjake, rekomandimi i Komisionerit 312/2011 është orientim i përgjithshëm i cili ka për qëllim që të përmirësojë përfaqësimin e pakicave etnike në polici. M rekomandim, midis të tjerash, propozohen masa të cilat do të sigurojnë që një numër proporcional të personave të pakicave etnike që të ndjekim mësimet në shkollat policore, si edhe masat të cilat do të sigurojnë mundësi punësimi në polici për studentët nga pakicat etnike (Ibid).

PËRFAQËSIMI I PAKICAVE ETNIKE NË SEKTORIN E SIGURISË NË SERBI

Sipas regjistrimit të popullsisë në Serbi në vitin 2011, pakicat etnike përbëjnë rreth 16% të popullsisë së përgjithshme (Zyra për Statistikë e RS, 2011). Edhe pse ka disa të dhëna për përfaqësimin e pakicave etnike në disa institucione publike, të dhënat gjithëpërfshirëse për përfaqësimin e pakicave etnike në mbarë administratën publike nuk ekzistojnë, dhe as të dhënat gjithëpërfshirëse për ndonjë nga pakicat etnike [Bjelosh, 2012: 254]. Prandaj, është e pamundur të caktohet nëse dhe në çfarë shkallë dispozitat kushtetuese dhe të ligjeve tjera të përmendura në tekstin e mësipërm janë respektuar nga Qeveria e Serbisë (Ibid).

Qendra e Beogradit për Politikë të Sigurisë e ka publikuar raportin në vitin 2008 dhe 2012 për përfaqësimin e pakicave në sektorin e sigurisë [Haxhiq et al, 2012; Haxhiq & Stojanović Gajić, 2012]. Konkluzioni themelor i vitit 2012 ishte se situata është përmirësuar deri në një masë që nga viti 2008, por edhe se pakicat etnike ende nuk janë përfaqësuar mjaft në sektorin e sigurisë së Serbisë edhe pse ekziston korniza ligjore e cila është e volitshme [Bjelosh, 2012]. Gjatë kërkimit të të dhënave për përfaqësimin e pakicave etnike në shkurt të vitit 2014, MPB-ja është përgjigjur se nuk mban të dhëna rreth përkatësisë etnike të të punësuarëve. Megjithatë, në konferencën e organizuar nga Qendra e për Politikë të Sigurisë në Beograd dhe Qendra për Studim të Sigurisë në Prishtinë më 27 qershor, përfaqësuesi i MPB-së i ka paraqitur numrat të cilët tregonin se ekziston praktika e përfaqësimit të pakicave etnike në polici. Sidoqoftë, autorët e këtij dokumenti nuk kanë mundësi të vlerësojnë nëse ka ndonjë progres në integrimin e pakicave deri tani.

Sipas të dhënave të QBPS nga viti 2010 [Bjelosh, 2012: 255-260], pakicat etnike janë të përfaqësuara në numër më të madh në Drejtori doganore - 13,5%, pastaj në Kuvendin Kombëtar - 12,4%. Në Ministrinë e Mbrojtjes pakicat etnike përbëjnë 12% nga

numri i përgjithshëm i të të punësuarëve (në ushtrinë e Serbisë vetëm 6%), në Ministrinë e Punëve të Brendshme 9,22%, kurse në Agjencinë për Inteligjencë dhe Siguri vetëm 5% e të punësuarëve nuk i përkasin shumicës kombëtare. Nuk është për t'u befusuar që përfaqësimi i pakicave etnike në nivelet më të larta, në pozita vendimmarrëse dhe komanduese në institucionet e sigurisë është edhe më i ulët në krahasim me numrin e përgjithshëm të të punësuarëve në sektorin publik (Ibid: 255). Dallimi i madh i përfaqësimit të disa pakicave etnike në popullsi dhe në sektorin publik është posaçërisht i dukshëm në qytetet dhe komunat shumëkombëshe në Serbi. Për shembull, boshnjakët përbëjnë më shumë se 70% të popullsisë së Novi Pazarit kurse vetëm 20% e boshnjakëve punojnë në policinë e Novi Pazarit (Ibid: 263-264). Situata është njësoj e pakënaqshme në disa komuna në Vojvodinë ku hungarezët përbëjnë shumicën por janë të përfshirë me më pak se 20% në policinë lokale (Ibid: 264). Pakica shqiptare është pakica më e përfaqësuar në polici për shkak të masave specifike të cilat janë ndërmarr gjatë viteve të fundit.

PËRFAQËSIMI I PAKICËS ETNIKE SHQIPTARE NË POLICI TË SERBISË: TË ARRITURAT DHE SFIDAT KRYESORE

Përfshirja e pakicave në sektorin e sigurisë është shumë e rëndësishme për demokratizimin e shoqërisë. Pjesëmarrja e tyre në institucionet e sigurisë dhe në marrjen e vendimeve është kyçe për mbrojtjen e të drejtave të tyre shoqërore dhe shmangien e përjashtimeve të mundshme. Duke e përmirësuar

përfshirjen e pakicave në sektorin e sigurisë, këto institucione transformohen në institucionet më përfaqësuese, duke kontribuar drejtpërsëdrejti në rritjen e besimit të qytetarët dhe përmirësimin e funksionimit të këtyre institucioneve. Madje, kjo e zmadhon bashkëpunimin mes qytetarëve dhe policisë në luftë kundër dukurive negative dhe e përmirëson sigurinë e të gjithë qytetarëve.

Duke iu referuar veçanërisht inkuadrimit të pakicave në polici, arritja e përfaqësimit të volitshëm cilësor sasior ofron kontribut konkret për përforcimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe rritje të efikasitetit operativ të policisë. Ky ka qenë rasti me përfaqësimin e pakicës shqiptare që jeton në pjesën jugore të Serbisë (në komunën e Preshevës, Bujanocit dhe të Medvegjës).

E vërteta është se për shkak të bojkotimit të regjistrimit të popullsisë në Serbi në vitin 2011 për pakicën shqiptare ka mungesa të të dhënave kur i referohet numrit total. Prandaj për të parandaluar çdo përshtypje të gabuar nga të dhënat demografike të regjistrimit të popullsisë së vitit 2011 rreth përbërjes etnike të këtyre tri komunave, ky raport do t'u referohet vetëm të dhënave nga regjistrimi i popullsisë nga viti 2002 që janë më të sakta (posaçërisht në rastin e banorëve shqiptarë). Më saktësi, sipas regjistrimit të popullsisë së vitit 2011, në Preshevë ka 416 shqiptarë etnikë, 2294 serbë; në Bujanoc 224 shqiptarë dhe 12,989 serbë; kurse në Medvegjë 527 shqiptarë dhe 6429 serbë (Popullsia sipas etnicitetit, 2011). Ndërkohë, sipas regjistrimit të popullsisë së vitit 2002 në këto tri komuna, pakica shqiptare përbën afro 116.000 banorë. Ky numër përfshin edhe personat që jetonin

Tabela 1. Struktura etnike e popullsisë në të tri komunat e jugut të Serbisë duke i përjashtuar ata që jetojnë jashtë vendit*

Komunat	Gjithsej		Shqiptarë		Serbë		Të tjerë	
	Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%
Presheva	34,904		31,098	89	2984	9	822	2
Bujanoci	43,302		23,681	55	14,782	34	4839	11
Medvegja	10,760		2,816	26	7,163	67	781	7

* Numri i qytetarëve që jetonin jashtë vendit për një kohë më të gjatë se një vit është: 13,000 nga Presheva, 11,000 nga Bujanoci dhe 3,000 nga Medvegja, Raporti komunal i Bujanocit, 24 qershor 2010.

jashtë vendit, numri i të cilëve është 27.000 nga numri i përgjithshëm (Regjistrimi i popullsisë, 2002). Duke i analizuar këta numra në përqindje, shqiptarët me 89% përbëjnë shumicën vendore në komunën e Preshevës. Njësoj, me 55% përfaqësojnë shumicën lokale edhe në komunën e Bujanocit kurse në komunën e Medvegjës përbëjnë 26% të popullsisë së përgjithshme (Ibid).

Duke e shikuar të kaluarën, deri në konfliktin e vitit 2000 pakica shqiptare ishte gati e përjashtuar nga sektori shoqëror, politik, ekonomik dhe i sigurisë. Niveli i përfaqësimit të tyre në institucionet e sigurisë së Serbisë duke i përfshirë edhe strukturat e policisë gati nuk ekzistonte. Më saktësisht, para konfliktit gjithsej kanë qenë vetëm 11 shqiptarë që punonin në policinë e Serbisë (Sh. Kamberi, 28.02.2014). Pas rritjes së tensioneve nga fundi i vitit 1990 të gjithë këta policë u larguan ose u detyruan të largohen nga puna. Që nga fundi i konfliktit në të tri komunat në vitin 2001, përpjekje të rëndësishme ka pasur për përfaqësimin e shqiptarëve në polici kurse nuk është punuar aq shumë për përmirësimin e përfaqësimit të tyre në institucione të tjera të sigurisë. Disa nga përpjekjet më të mëdha në këtë drejtim kanë ndodhur kryesisht menjëherë pas konfliktit. Pas rënies së regjimit të Millosheviqit në tetor të vitit 2000, Qeveria serbe ka filluar të ndërmarrë hapat e parë për arritjen e marrëveshjes paqësore. I ashtuquajturit Plani i Çoviqit është krijuar në vitin 2001 nga zëvendëskryeministri i atëhershëm Nebojsa Çoviq i cili parashikonte, midis tjerash, zhvillimin e sigurisë dhe të ekonomisë, zhvillimin e shoqërisë shumëkombëshe dhe shumëfatore të bazuar në parimet demokratike dhe

respektimin e të gjitha të drejtave të njeriut, të drejtat politike dhe të pakicave (Stodiek, 2006: 43). Me përkrahje të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Qeveria serbe ka ndërmarrë disa masa konkrete duke përfshirë elementin shumëkombëtar në stacionet policore të cilat operonin në komuna të banuara me shqiptarë. Progres i rëndësishëm është arritur posaçërisht gjatë viteve 2001 - 2004. Megjithatë këto masa kanë qenë afatshkurtra sepse nga viti 2005 ka pasur progres të kufizuar në këtë çështje (Popoviq, 21.02.2014).

Gjatë viteve 2001 - 2004, 400 policë nga të cilët 270 shqiptarë dhe 130 serbë e kanë kryer trajnimin që të marrin pjesë në elementin shumëkombëtar (Halimi, 27.02.2014). Trajnimi themelor i realizuar në Mitrovo Pole ka zgjatur tre muaj dhe është realizuar vetëm në vitin e parë. Trajnimin themelor është ndjekur me trajnim në vend të punës prej 15 javësh me policët ndërkombëtarë si këshilltarë dhe me planet dhe programet e marra nga Akademia policore e OSBE-së në Kosovë që janë përshatur me legjislacionin e Serbisë.

Interesimi i qytetarëve shqiptarë nga jugu i Serbisë për të hyrë në polici është rritur që nga momenti i shpalljes së informimit për konkursin e parë për formimin e elementit shumëkombëtar. Është e mundur që sukcesi i krijimit të policisë shumëkombëtare pas konfliktit e ka rritur besimin ndaj policisë më shumë se sa besimi në ndonjë institucion tjetër të sigurisë në Serbi dhe më shumë se sa besimi që kanë serbët (BCSP, 2013). Në përgjithësi, interesimi i pakicës shqiptare për t u përfshirë në policinë e Serbisë është në

Tabela 2. Bashkësia Numri i personelit Shqiptarë Serbë Romë*

Bashkësia	Numri i personelit	Shqiptarë		Serbë		Romë	
		Nu.	%	Nu.	%	Nu.	%
Presheva	248	125	50.4	120	48.4	3	1.2
Bujanoci	307	107	35	198	65	2	0.65
Medvegja	142	7	5	133	93.6	2	1.4
Gjithsej	697	239	30	451	69	7	1

* Etnička struktura stanovništva, zapošljenih i rukovodioca organa, institucija i preduzeća u opštinama Preševo, Bujanovac i Medveđa, Savet za Ljudska Prava, Preševo 2011/2012 [Struktura etnike e popullsisë, e të punësuarëve dhe e udhëheqësve të organeve, institucioneve dhe ndërmarrjeve në komunën e Preshevës, Bujanocit dhe të Medvegjës, Këshilli për të Drejtat e Njeriut, Preshevë 2011/2012]

nivel të volitshëm, gjë që shihet edhe sipas anketimit të nxënësve të shkollave të mesme për preferencat e tyre për punë [Stojanović, 2008: 169]. Mundësia e punësimit është gjithashtu motiv i pakicës shqiptare për t'u bërë pjesë e policisë [Stojanović, 2009: 2]. Shqiptarët etnikë përbëjnë 50.4% të policëve në Preshevë, 35% në Bujanoc dhe vetëm 5% të policëve shqiptarë punojnë në Medvegje (Halimi, 27.02.2014). Megjithatë, në kuptim të përgjithshëm përfaqësimi i shqiptarëve në polici në këto tri komuna është ende i ulët duke konsideruar se ata përbëjnë vetëm 25% të numrit të përgjithshëm të policëve kurse shqiptarët në këto komuna përbejnë 65% të numrit të përgjithshëm të popullsisë (Halimi, 27.02.2014). Përfaqësimi i shqiptarëve në drejtoritë rajonale të policisë gati se nuk ekziston, vetëm një polic shqiptar punon në drejtorinë rajonale në Vranjë. Deri më 2011 nuk ka pasur shqiptarë në polici kufitare përkundër faktit se zona kufitare është e banuar me shqiptarë. Tani numri i shqiptarëve në policinë kufitare është 5 [Sh. Kamberi, 28.02.2014]. Gjëja që mbetet shqetësuese është se në të gjitha rastet kur policët nga pakica shqiptare përçarëdo shkak largohen ose janë larguar nga puna, pozita e tyre plotësohet kryesisht me përfaqësuesit e komuniteteve tjera pa e marrë parasysh zëvendësimin e pozitës me komunitetin përkatës.

Sfidë edhe më të madhe paraqet obligimi i krijimit të ambientit që do t'i lejojë përfaqësuesit e pakicës kombëtare shqiptare të zhvillojnë karrierë dhe të avancohen në pozitë udhëheqëse. Përveç trajnimit në vendin e punës që bëhet në tri komuna të jugut të Serbisë, shumë pak shqiptarë kanë pasur mundësi të ndjekin programet e edukimit në Beograd. Nga 270 shqiptarë etnikë të punësuar në vitin 2001 vetëm 8 policë kanë pasur mundësi të vazhdojnë trajnimin e tyre në Beograd. Nga ky numër gjatë periudhës 12 vjeçare vetëm një person ka pasur mundësi të vazhdojë trajnimin në Akademinë e Kriminalistikës dhe të Studimeve Policore në Beograd [B. Kamberi, 27.02.2014]. Një person tjetër i cili ka arritur me sukses deri në provimet pranuese është shkualifikuar për shkak të njohjes së pamjafueshme të gjuhës serbe. Mungesa e shkathtë-

sisë në gjuhën serbe është treguar si një nga sfidat kryesore për të rinjtë shqiptarë dhe për mundësi të zhvillimit të karrierës në policinë e Serbisë. Disa masa afirmative janë ndërmarrë përmes krijimit të materialeve promovuese³ dhe pjesëve në provim pranues për trajnim themelor në polici në gjuhën shqipe. Në bazën *ad hoc* këshillimi dhe edukimi në gjuhën serbe iu janë mundësuar kandidatëve të pakicës shqiptare për rritjen e numrit të kandidatëve të pakicave që të marrin pjesë në trajnim dhe avancim në policinë e Serbisë. Prandaj, ekziston nevoja që këto programe të planifikohen edhe me buxhet nga ana MPB në bashkëpunim me Trupin Koordinues për Bujanoc, Medvegje dhe Preshevë për të siguruar qëndrueshmërinë e veprimeve. Ato mund të krijohen duke u bazuar në modelin për mësim të gjuhës serbe dhe praktikë profesionale⁴ në administratën qendrore publike e cila është mundësuar me përkrahje të Ambasadës së Britanisë së Madhe në Serbi (Aktivitetet e Trupit Koordinues, 2013). Strukturat e trajnimit dhe të edukimit policor në MPB të Serbisë duhet të kenë si qëllim bashkëpunimin me bashkësinë lokale që të tërheqin kandidatët e kualifikuar për edukim të lartë policor në Beograd.

Gjatë tri vjetëve të fundit janë realizuar disa programe shtesë për përfshirjen e pakicave. Në nëntor të vitit 2011, MPB ka organizuar aktivitete për promovim me qëllim të popullarizimit të profesionit të policit në mesin e shqiptarëve; është krijuar softueri shumëgjuhësorë për t'u mundësuar kandidatëve testin hyrës në gjuhën amtare. Në tetor të vitit 2012, me përkrahje të OSBE-së, MPB ka organizuar takim me mësuesit e gjuhës serbe nga Presheva, Bujanoci dhe Vranja për organizimin e kurseve të gjuhës serbe për anëtarët e pakicës shqiptare me qëllim të ndihmës së integritit dhe kalimit të provimit hyrës. Në mars të vitit 2014, përfaqësuesit e Qendrës për trajnim themelor policor, në bashkëpunim me OSBE kanë mbajtur seminar në të cilin kanë marrë pjesë pakicat etnike

3 http://www.copo.edu.rs/Albanski_jezik-187-1

4 <http://www.juznevesti.com/Drushtvo/Koordinaciono-telo-pomaze-buducim-policaicima.sr.html>

Tabela 3. Përfaqësimi etnik në udhëheqësinë policore në të tri komunat*

Rangu	Preshevë	Bujanoc	Medvegjë
Shef	shqiptar	serb	serb
Komandant	serb	serb	serb
Zëvendës komandant	shqiptar	shqiptar	serb
Ndihmës komandant	tre serbë; një shqiptar	katër serbë	katër serbë

* Intervistat me policët nga Bujanoci dhe Presheva, 27 dhe 28 shkurt 2014.

nga Subotica, Vranja, Sremska Mitrovica, Beograd, Uzhica, Valeva, Bori, Pozharevci dhe Kikinda [Arsenijeviq, 27.06.2014]. Të gjitha këto aktivitete, si dhe aktivitetet nga e kaluara, janë realizuar me përkrahje të jashtme kurse për qëndrueshmeri dhe ndryshime duhet të bëhen përpjekje të vazhdueshme buxhetore.

Për të mësuar për pikëpamjet e policëve shqiptarë dhe duke pasur si qëllim shtypjen e këtij botimi kemi bërë intervista me gjashtë policë shqiptarë të cilët kanë përvojë pune nga një deri në njëzet vjet pune. Të gjithë policët kanë treguar se kanë pasur përvojë shumë të mirë në trajnim themelor dhe në vend të punës. Ata janë trajtuar në mënyrë të barabartë si dhe anëtarët e komuniteteve tjera dhe nuk kanë përjetuar asnjë formë të diskriminimit etnik. Madje, asnjë nga policët e intervistuar nuk kanë përjetuar asnjë problem në stacionet e tyre në bazë të profilimit etnik. Megjithatë, ata kanë shprehur brengë se udhëheqësia qendrore (MPB) dhe udhëheqësit preferojnë përfaqësues të shumicës serbe.⁵ Madje, kur është fjala për promovimin në pozitë udhëheqëse, ata e kanë vërejtur se ka pasur përpjekje për dekurajim të zyrtarëve të përkatësisë etnike shqiptare duke nënvizuar se nuk ka trajtim të barabartë në nivele të larta të menaxhimit policor në këto tri komuna [polici 12, 2014].

5 Polici ka kërkuar të jetë anonim edhe pse ka pasur leje nga Ministria e Brendshme për intervistë me përfaqësuesit e organizatës civile. Kjo mungesë e vullnetit për të folur tregon se ekziston një lloj frike që të flasë për pakënaqësitë dhe për parregullsitë brenda policisë sepse mund të ketë si rezultat humbjen e punës dhe/ose mosbesimin ndaj të dyja palëve.

SFIDAT PËR INKUADRIM TË PAKICËS SHQIPTARE NË MJEDIS TË POLICISË SË SERBISË

Ndër sfidat kryesore me të cilat bashkësia e pakicës shqiptare ballafaqohet kur është fjala për inkudrimin në institucionet e sigurisë janë: mungesa e vazhdimësisë së masave afirmative nga aktorët politikë në nivel qendror dhe vendor; mosnjohja e sistemit të edukimit ku shumica e anëtarëve të bashkësisë shqiptare i ndjekin studimet; kufizimet në përdorimin e gjuhës amtare në komunat ose qytetet ku kjo pakicë etnike është më shumë e përqendruar; marrëdhëniet ndër-etnike midis komunitetit serb dhe shqiptar; prania e tepërt e ushtrisë dhe e forcave të xhandarmërisë në rajonet e banuara me shqiptarë; dhe kompetencat e kufizuara territoriale të policisë lokale.

Grupi i dytë i sfidave katërbëjë me kompetencat e policisë lokale të cilat janë të kufizuara edhe në territorin për të cilin ata janë përgjegjës. Në këtë rajon, prania e xhandarmërisë është shumë e dukshme. Me pajisje të mëdha ushtarake, forcat e xhandarmërisë në mënyrë të vazhdueshme patrollojnë në territorin e Luglinës së Preshevës.

Ambienti politik

Në përgjithësi, përfaqësuesit e organizatës joqeveritare në Beograd konsiderojnë se ka vullnet të kufizuar politik në mesin e institucioneve të sigurisë që të merren me çështje të përfaqësimit etnik në sektorin e sigurisë. Çështja e përfaqësimit etnik në sektorin e sigurisë së Serbisë ka qenë në masë të

madhe e përjashtuar nga diskursi si pasojë e konfliktit në Preshevë, Bujanoc dhe në Medvegjë. Si rezultat, deri tani nuk ka pasur analiza publike të disponueshme për nivelin e përfaqësimit të pakicës etnike shqiptare në forcat e sigurisë serbe duke e përfshirë avancimin në pozitat e larta. Nuk ka dëshmi nëse ka ndonjë agjendë/politikë nga MPB e cila ka për qëllim rritjen e integritit të shqiptarëve ose të minoriteteve të tjera në institucionet e sigurisë së Serbisë. Shumica konsiderojnë se kur është fjala për pakicën shqiptare arsyeja kryesore për mungesën e vëmendjes institucionale janë marrëdhëniet e afërta mes këtij komuniteti me shqiptarët e Kosovës, si dhe mosbesimi i cili është mbjellë në të kaluarën nga zyrtarët serbë ndaj kolegëve të tyre të përkatësisë etnike shqiptare.

Mangësia që kësaj çështjeje t'i jepet përparësi mund të jetë krijuar nga mungesa e përkrahjes publike për inkuadrimin e shqiptarëve në shoqëri serbe. Anketa aktuale e opinionit publik rreth diskriminimit në Serbi tregon se 76% e qytetarëve i përkrahin nismat për masat afirmative të cilat ua mundësojnë punëdhënësve të punësojnë në përqindje adekuate anëtarët e grupeve të diskriminuara [Komisioni për Mbrojtjen e Barazisë, 2012: 23]. Megjithatë e njëjta anketë tregon nivel më të lartë të distancës etnike ndaj shqiptarëve etnikë vendorë. Më shumë se gjysma e të anketuarëve nuk i duan shqiptarët në familjet e tyre, 25% e të anketuarëve nuk dëshirojnë të jetojnë në afërsi të shqiptarëve, kurse një e pesta e të anketuarëve mendojnë se shqiptarët nuk duhet të jenë qytetarë të Serbisë [Ibid, 2012: 26]. Në anën tjetër, duket se elita politike e shqiptarëve është duke bërë përpjekje të vogël për përfaqësimin e shqiptarëve në strukturat e sigurisë serbe. Ka forca të cilat janë të interesuara vetëm për të pasur pushtet lokal dhe si të tilla nuk kanë interesim për nivel më të gjerë, rajonal ose kombëtar, dhe këto konfrontime mes subjekteve politike ndikojnë në jetën e qytetarëve shqiptarë. Në përgjithësi, shqiptarët që jetojnë në jug të Serbisë presin shumë nga bisedimet në mes Beogradit-Prishtinës dhe ata presin rezultate konkrete që do ta përmirësojnë situatën e tyre si dhe në mënyrë afatgjatë presin që

shtendosja dhe normalizimi i marrëdhënieve në mes Beogradit dhe Prishtinës të ndikojë në sigurinë e shqiptarëve që jetojnë në këto pjesë [Sh. Kamberi, 2014].

Trashëgimia e luftës dhe pasojat psikologjike të luftës

Mosinteresimi i shqiptarëve për të qenë pjesë e strukturave të sigurisë së Serbisë gjithashtu ka të bëjë me trashëgimin nga konflikti dhe segregacioni i pakicës shqiptare posaçërisht në kohën e regjimit të Millosheviqit. Ka pasur ftesa nga përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të cilat i kanë ftuar institucionet që të merren me pasojat e së kaluarës për të ecur përpara në krijimin e besimit në tri komunat e Serbisë Jugore të banuara me bashkësi shqiptare. Sipas përfaqësuesit të Fondit për të Drejtën Humanitare, 15% e zyrtarëve në mbarë sektorin e sigurisë së Serbisë dyshohen se kanë bërë krime të luftës në Kosovë ose në pjesë të tjera të ish-Jugosllavisë [Kos-tiq, 06.03.2014]. Në anën tjetër, numri i madh i krimeve të luftës të kryera nga forcat ushtarake dhe paramilitare gjatë viteve 90-ta ende duhet të procedohet në gjykata. Ndërsa procesi i nxjerrjes para bankës së drejtësisë nuk po ndodh, kështu që është jashtëzakonisht vështirë të pritet nga pakica shqiptare t'u besojë insitucioneve të sigurisë [B. Kamberi, 27.02.2014]. Gjithashtu, kur është fjala për polici, kanë ekzistuar disa çështje të cilat Qeveria pas Millosheviqit ka planifikuar t'i zgjidhë. Këto e kanë nënkuptuar depolitizimin, decentralizimin dhe demilitarizimin e policisë, që nuk janë arritur për shkak të mungesës së politikave adekuate që kanë pasur për qëllim të ballafaqohen me këto çështje [Bakij, Gajiq, 2006].

Prania e xhandarmërisë dhe të forcave ushtarake

Ka mendime të ndryshme mes autoriteteve kombëtare dhe vendore sa i përket nevojës për praninë e xhandarmërisë në jug të Serbisë. Ndryshe nga autoritetet qendrore, për autoritetet vendore dhe përfaqësuesit e sho-

qërisë civile, prania e xhandarmërisë në jug të Serbisë nuk është më e nevojshme [Popoviq, 2007: 45]. Prania e madhe e forcave ushtarake dhe e xhandarmërisë serbe në rajonin e banuar me pakicë shqiptare ka efekte negative psikologjike te qytetarët [Dragan Popoviq, 21.02.2014]. Kjo prani kontribuon që shqiptarët etnikë edhe më tutje të ruajnë mosbesimin ndaj këtyre dy institucioneve të sigurisë. Si rezultat, gati asnjë anëtar i pakicës shqiptare ende nuk ka shprehur vullnet për të marrë pjesë në ushtri ose xhandarmëri. Madje, anketimi i organizuar nga SEESAC tregon se 43% e shqiptarëve mendojnë se siguria e përgjithshme në masë të madhe është e rrezikuar nga xhandarmëria serbe [Stodiek, 2006: 53]. Përdorimi masiv (rreth 100 anëtarë) madje edhe në raste kur policia lokale mund t'i kryente operacionet, ka rezultuar në bllokimin e pjesës së qytetit për një kohë të gjatë duke krijuar tensione të mëdha dhe ndjenjën e pasigurisë te qytetarët [Halimi, 27.06.2014].

Duhet të krijohen kushtet që shqiptarët të marrin pjesë në xhandarmëri sepse përdorimi i tepërt dhe nganjëherë i jashtëzakonshëm i xhandarmërisë e komprometon punën e këtij institucioni dhe si pasojë ndikon në vullnetin e shqiptarëve që të marrin pjesë në xhandarmëri [Halimi, 27.06.2014]. Një nga të ashtuquajturit përparim në këtë çështje është që nga viti 2004 shkelja e të drejtave të njeriut nga policia, xhandarmëria janë duke u zvogëluar por frika nga prania e tyre e tepërt mbetet e vazhdueshme [B. Kamberi, 2014].

Faktorët ekonomikë

Zhvillimi ekonomik i kufizuar dhe niveli i lartë i papunësisë konsiderohen faktorë kryesorë që shkaktojnë që pakica shqiptare të hyjë në polici serbe. Situata ekonomike paraqet një nga problemet kryesore për Luginën e Preshevës. Situata ekonomike në këtë pjesë të shtetit është e dobët në krahasim me pjesët e tjera të shtetit, gjë e cila kryesohet nga niveli i lartë i papunësisë me 49%, kurse si krahasim në mbarë Serbinë përqindja e papunësisë është 20.1% [Grupi i Bankës Botërore, 2014:

2]. Përqindja më e lartë e papunësisë është në Preshevë me 56%, pastaj në Medvegjë me 46% dhe në Bujanoc me 43% [Stankoviq, 11.03.2013]. Situata e rëndë ekonomike është konsideruar nga shumica e popullsisë lokale si një prej faktorëve kryesorë që kontribuojnë negativisht në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike. Për të argumentuar edhe më saktësisht këtë, 95% e shqiptarëve mendojnë se faktori më i rëndësishëm për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike është zhvillimi ekonomik, dhe pastaj vjen zgjidhja e çështjeve politike me 91%. [QBPS, 2013: 7]

Edukimi dhe përdorimi i gjuhës amtare

Mungesa e njohjes së gjuhës serbe është problem kryesor me të cilin po ballafaqohet pakica shqiptare kur është fjala për integrimin e tyre në sektor publik. Në komunat ku pakica shqiptare e përbën shumicën në nivel lokal ka probleme me zhvillimin e dygjuhësisë/bilingualizimit. Ky problem është i shkaktuar më shumë nga mungesa e vullnetit të nivelit qendror që reflektohet me investime të kufizuara në burimet njerëzore [përkthyesit, ligjëruesit] në institucionet publike në këto tri komuna. Edhe pse është kështu, nga viti 2011 dega e Departamentit të Fakultetit Ekonomik të Subotićës është hapur në Fakultetin Ekonomik të Bujanocit, dhe për shkak të mungesës së degëve tjera dhe mundësive të edukimit universitar në gjuhën shqipe, shumica e pakicës shqiptare e cila jeton në Serbi studion jashtë vendit, në Kosovë, Maqedoni dhe në Shqipëri në gjuhën amtare.

Progres i kufizuar është arritur në njohjen e diplomave. Nga viti 1990 deri në vitin 2002, autoritetet e Serbisë nuk i kanë pranuar diplomatat e Universitetit të Kosovës [Halimi, 27.02.2014]. Në vitin 2002, pas marrëveshjes paqësore me të cilën kanë mbaruar konfliktet në Preshevë, Medvegjë dhe në Bujanoc, qeveria ka vendosur t'i pranojë të gjitha diplomatat nga Kosova. Kjo situatë ka vazhduar deri më 2008 kur Ministria e Arsimit e Qeverisë së kryeministrit Koshtunica ka vendosur të mos i njohë diplomatat. Ky vendim është

marrë për shkak të shpalljes së pavarësisë së Kosovës (Sh. Kamberi, 2014). Kjo periudhë ka zgjatur një vit, deri në vitin 2009, kur bashkësia ndërkombëtare ka ndikuar në Qeverinë e Serbisë për zgjidhje të çështjes (Ibid). Marrëveshja për njohje të dyanshme të diplomave universitare nëpërmjet certifikimit nga ana e Asociacionit të Universiteteve Evropiane (EUA) është arritur me 2 korrik 2011 dhe ka përfunduar me 21 nëntor 2011, kurse zbatimimi ka filluar në shkurt të vitit 2012 (Gjendja aktuale, 2014: 29). Marrëveshja e ka ofruar mënyrën për njohjen e diplomave universitare duke parashikuar mundësimin që diplomat të hyjnë në procedurën e njohjes e cila para kësaj marrëveshjeje ka qenë e pamundur. Akoma, ky progres i arritur nuk ofron zgjidhje të plotë sepse nuk i obligon universitetet në Serbi dhe punëdhënësit t'i pranojnë diplomat e vlefshme. Ndërkohë, në disa raste kur diplomat nga Kosova janë pranuar emërtimi "Kosovo dhe Rrafshi i Dukagjinit" është shtuar në diplomë (KIPRED, 2013:20).

Sipas raportit të Qeverisë së Kosovës, deri në këtë moment, janë pranuar 279 paraqitje nga Asociacioni i Universiteteve Evropiane (EUA), por asnjë prej tyre nuk është certifikuar dhe asnjë letër zyrtare e pranimit nuk është lëshuar nga institucionet e Serbisë (Gjendja aktuale, Qeveria e Kosovës, 2014: 29). Nuk ka pasur progres sa i përket kësaj çështjeje, madje një hap prapa ka ndodhur me 30 prill 2014 kur Gjykata Kushtetuese e Serbisë ka vendosur⁶ të suspendojë njohjen e diplomave të Kosovës. Ky hap e dëmton rininë shqiptare pasi që vështirësitë për integrim në sektorin socio-politik, ekonomik, të sigurisë dhe të sektorëve tjerë e redukton mundësitë e punësimit dhe të vazhdimin të edukimit në Serbi dhe kjo do të vazhdojë të paraqesë problem për prosperitetin e tyre. Bashkësia ndërkombëtare duhet të vëzhgojë dhe të përkrahë progresin e marrëveshjes së arritur në Bruksel e cila, mes të tjerash, par-

ashikon njohje të dyanshme të diplomave të cilat mund të kalojnë procesin a aprovimit të EUA-së.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Pavarësisht nga progresi i arritur në dhjetëvjeçarin e fundit, pakica shqiptare në Serbi akoma mbetet jo mjaft e përfaqësuar në institucionet e sigurisë. Një lloj përparimi në përfaqësimin e pakicës shqiptare në nivelet dhe pozitat e ulëta në policinë lokale në komunat e Preshevës dhe Bujanocit është arritur nga fundi i konflikteve në këto komuna në vitin 2001. Përfaqësimi i vogël i kësaj pakice etnike mbetet në pozita të larta. Duke krahasuar situatën e pakicës shqiptare në Serbi me standardet evropiane, kjo ende nuk është e volitshme. Përfshirja e pakicës etnike shqiptare në policinë e Serbisë në tri komuna të banuara me pakicën shqiptare lokale ka rezultuar në rritjen e besimit të tyre në polici. Sido që të jetë, pas datës së fillimit të negociatave për integrim në BE [21 janar 2014], Qeveria e Serbisë duhet të demonstrojë më shumë vendosmëri në trajtimin e inkuadrimit të pakicave për të arritur përparim të duhur në këtë fushë.

Duke u bazuar në zbulimet e paraqitura në këtë raport, Qeveria e Serbisë dhe institucionet vendore rekomandohen që të ndër marrin disa hapa konkretë për integrimin e pakicës shqiptare në nivel lokal në policinë e Serbisë:

1. Ministria e Punëve të Brendshme duhet të krijojë politika të qarta për të promovuar inkuadrimitin e pakicës shqiptare në të gjitha strukturat dhe pozitat. Njëra nga masat që mund të ndërmerret është partneriteti me Trupin Koordinues për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë; dedikimi i mjeteve buxhetore, këshillimi dhe mësimi i gjuhës për policët të cilët mund të kontribuojnë në rritjen e kandidatëve të pakicës etnike për zhvillimin e karrierës dhe avancimin në policinë e Serbisë.

6 Neshiq Milan, Odluka o neustavnosti diploma ozbiljan test/Vendimi për diplomat jokushtetuese test serioz, Radio Slobodna Evropa/Radio Evropa e Lirë, link: <http://www.slobodnaevropa.org/content/odluka-o-neustavnosti-diploma-ozbiljan-test/25377887.html>, 08.05.2014, qasja e fundit më 21.07.2014

Programi mund të zhvillohet nga MPB në bashkëpunim me Trupin Koordinues për Bujanoc, Medvegjë dhe Preshevë në bazë të modelit të kurseve të gjuhës serbe dhe stazhit në administratën publike qendrore i cili ka qenë i ofruar nga Ambasada e Britanisë në Serbi.

2. Bashkëpunimi mes shtetit/institucionet qendrore dhe autoritetet lokale ka nevojë të përmirësohet për të siguruar përfaqësim më të qëndrueshëm të pakicës etnike shqiptare në institucionet e sigurisë së Serbisë. Strukturat e edukimit të policisë në MPB të Serbisë duhet të caktojnë qëllimin për të punuar se bashku me bashkësinë vendore për të tërhequr kandidatë të kualifikuar për edukim të lartë në Beograd.
3. Njohja e diplomave universitare nga Kosova duhet të bëhet sa më shpejtë. Ka nevojë për krijimin e politikave të lehtësimit sepse ky proces është i gjatë dhe kërkon investime financiare të shumta.
4. Për krijimin e ambientit miqësor dhe për dhënien e kontributit pozitiv në marrëdhëniet ndëretnike në komunën e Bujanocit, Preshevës dhe të Medvegjës dhe për krijim të ndjenjës së sigurisë, ka nevojë për reduktime drastike të pranisë së ushtrisë dhe të xhandarmërisë sa më herët që është e mundur. Prania e tyre nuk e pasqyron gjendjen e sigurisë në terren kurse reputacioni i tyre negativ i zhvilluar gjatë dy dekadave të fundit ka krijuar mjedis të parregulluar për pakicën shqiptare. Tensioni i krijuar dhe pakënaqësia e shqiptarëve për këtë çështje do të përmirësohet nëse xhandarmëria do të ndryshojë praktikën e cila i frikëson qytetarët që e respektojnë ligjin.

BIBLIOGRAFIA

Legjislacioni dhe botimet e qeverisë:

- 2002 Regjistrimi i popullsisë, shtëpive dhe i banesave, etniciteti – data sipas rajoneve, Zyra e Statistikës e Republikës së Serbisë, Beograd, linku: <http://webrzs.stat.gov.rs/axd/en/popis.htm>, shkurt 2003, hyrja e fundit në link më 5 maj 2014.
- Komisioneri për Mbrojtjen e Barazisë në Republikën e Serbisë, rekomandimi për Ministrinë e Punëve të Brendshme, Nr. 312/2011.
- Këshilli i Evropës [1995[1]] Konventa Korniza e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, ETS Nr. 157.
- Këshilli i Evropës [1995[2]] Raporti Shpjegues për Kornizën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.
- Këshilli i Evropës [1993] Konkluzion i prezidiumit të Kopenhagës, 7.A.iii.
- Informacion për aktivitetet e Trupit Koordinues, linku: http://www.kt.gov.rs/images/Informacije%20o%20aktivnostima%20Koordinacionog%20tela_2013_srb.pdf, dhjetor 2013, hyrja e fundit në link më 5 prill 2014.
- Kuvendi Kombëtar i Republikës së Serbisë [2002] Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Pakicave Kombëtare, Gazeta Zyrtare e RFJ, Nr. 11/2002.
- Kuvendi Kombëtar i Republikës së Serbisë [2005[1]] Ligji për Punë, Gazeta Zyrtare e RS, Nr. 24/2005, 61/2005, 54/2009 dhe 32/2013.
- Kuvendi Kombëtar i Republikës së Serbisë [2005[2]] Ligji për Punonjësit Civilë, Gazeta Zyrtare e RS, Nr. 79/2005.
- Kuvendi Kombëtar i Republikës së Serbisë [2006] Kushtetuta e Republikës së Serbisë, Gazeta Zyrtare e RS, Nr. 98/2006.
- Kuvendi Kombëtar i Republikës së Serbisë [2007] Ligji për Mbrojtje, Gazeta Zyrtare e RS, Nr. 116/2007.
- Kuvendi Kombëtar i Republikës së Serbisë [2007] Ligji për Ushtri, Gazeta Zyrtare e RS, Nr. 116/2007.
- Kuvendi Kombëtar i Republikës së Serbisë [2009] Ligji për Ndalim të Diskriminimit, Gazeta Zyrtare e RS, Nr. 22/2009.
- Përgjigjja negative nga Ministria e Punëve të Brendshme pas kërkimit të të dhënave, numri 1586/14, 21 shkurt 2014.
- Popullsia sipas përkatësisë etnike, linku: <http://webrzs.stat.gov.rs/WebSite/Public/ReportResultView.aspx?rptId=1210>,
- Gjendja në zbatimin e marrëveshjes së Brukselit, linku: <http://www.peacefare.net/wp-content/uploads/2014/02/Kosovo-Report-on-implementation-state-of-play-of-the-Brussels-Agreements-160114-signed-2.pdf>, Prishtinë, më 16 janar 2014, hyrja e fundit në link 6 maj 2014.
- Kuvendi i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara [1992] Deklarata për të Drejtat e Personave të Pakicave Etnike ose Kombëtare, Pakicave Fetare dhe Gjuhësore, e miratur me Rezolutën 47/135 e 18 dhjetorit të vitit 1992.

Raportet dhe botimet:

- Bakiq, Branka dhe Gajiq, Novak, Reforma e policisë në Serbi: Pesë vjet pas, Edicioni për Ballkan 06/21, link: http://www.ssrnetwork.net/uploaded_files/4187.pdf, maj 2006, hyrja e fundit në web faqen më 6 maj 2014.
- Bjellosh, Maja [2012] 'Përfaqësimi i grave dhe i pakicave kombëtare', në Haxhiq, M. & Stojanović Gajiq, Sonja. Eds. *Raport vjetor për reformimin e sektorit të sigurisë në Serbi*, Beograd: BCBP dhe Gazeta Zyrtare e RS, 240-266.
- Komisioneri për Mbrojtjen e Barazisë i Republikës së Serbisë [2012] Raport për hulumtim të mendimit publik Qëndrimet e qytetarëve rreth diskriminimit në Serbi, Beograd: UNDP.
- Komisioneri për Mbrojtjen e Barazisë, Qendra për Zgjedhje të Lira dhe Demokraci [CeSID], linku: http://www.ravnopravnost.gov.rs/jdownloads/files/izvestaj_diskriminacija__cpe_cesid_undp_decembar_2012.pdf, Beograd, dhjetor 2012, hyrja e fundit në web faqe më 5 maj 2014.
- Komiteti për Eliminim të Diskriminimit Racor [2011] Vëzhgime përmbyllëse të

- Komitetit për Eliminim të Diskriminimit Racor: Serbia, CERD/C/SRB/CO/1, më 13 prill 2011.
- Deda, Ilir dhe Qosaj-Mustafa, Ariana, Implementimi i marrëveshjes për dialog politik Kosovë-Serbi, KIPRED, link: http://www.kipred.org/advCms/documents/22356_The_Implementation_of_Agreements_of_Political_Dialogue.pdf, Prishtina, korrik 2013.
 - Qytetarët rreth marrëdhënieve serbo-shqiptare dhe bashkëpunimin në çështjet e sigurisë: analiza komparative e qëndrimeve të qytetarëve të jugut të Serbisë dhe në nivelin e mbarë vendit, Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë [QBPS], Beograd, nëntor 2013.
 - Haxhiq, Miroslav & Milosavljeviq, Bogolub & Stojanoviq, Sonja & Ejduš, Filip, et al., *Raport vjetor për reformimin e sektorit të sigurisë në Serbi* 2008, BCSP, link: <http://www.bezbednost.org/upload/document/yearbook.pdf>, Beograd, 2008.
 - Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut [2013] Të drejtat e Njeriut në Serbi 2012 – Popullizëm: Ulja e vlerave demokratike, Beograd: Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.
 - Human Rights Watch [2014] Raporti botëror 2014: Serbia, në: <http://www.hrw.org/world-report/2014/country-chapters/serbia?page=2>
 - Maroviq, Marija & Ejduš, Filip & Kostiq Ivan, Përplasje e perceptimit? Siguria në Serbinë Jugore, Misioni i OSBE-së në Serbi dhe Qendra Ballkanike për Lindjen e Mesme, Beograd, dhjetor 2012.
 - Memisoglu, Fulya [2007] Politika e Bashkimit Evropian për të Drejtat e Pakicave dhe efekti i tij në zhvillimin e mbrojtjes së të drejtave të pakicave në Greqi, dokumenti i përgatitur për simpoziumin e tretë të doktorantëve për Greqinë moderne: strukturat, konteksti dhe sfidat, Observatori Helenik, Instituti Evropian, LSE, qershor 14-15, 2007.
 - Anketimi i opinionit publik nëntor 2012, Qëndrimi i qytetarëve rreth diskriminimit në Serbi, linku: http://www.ravnopravnost.gov.rs/jdownloads/files/izvestaj_diskriminacija__cpe_cesid_undp_decembar_2012.pdf, Beograd, dhjetor 2012, hapja e fundit 5 maj 2014.
 - Reforma e policisë në Serbi, OSBE, linku: <http://www.osce.org/serbia/18310?download=true>, janar 2004.
 - Popoviq, Gjorgje, Zhandarmëria ose policia lokale shumëetnike?, Siguria e Ballkanit Perëndimor, Vëllimi: 4 / 2007.
 - Rekomandime për punën e policisë në shoqëritë multietnike, Zyra e OSBE e Komisionerit të lartë për pakica kombëtare, linku: <http://www.osce.org/hcnm/32227?download=true>, shkurt 2006, hyrja e fundit më 7 maj 2014.
 - Stankoviq, Të drejtat e shqiptarëve nuk janë të rrezikuara, linku: <http://www.kt.gov.rs/sr/news/arhiva-vesti/prava-albanaca-nisu-ugrozena.html>, 11 mars 2013
 - Zyra për Statistikë e Republikës së Serbisë [2011] Regjistrimi i popullsisë 2011 Përkatësia etnike, Beograd: Zyra për Statistikë e Republikës së Serbisë.
 - Stodiek, Thorsten [2006], OSBE dhe krijimi i policisë shumëetnike në Ballkan, Instituti për Hulumtimin e Paqes dhe Politikat e Sigurisë në Universitetin e Hamburgut, link: http://www.core-hamburg.de/documents/CORE_Working_Paper_14.pdf, Hamburg, 2006.
 - Strategjia për integrimin e pakicës shqiptare në Serbi, Qendra për Politika, linku: <http://www.policycenter.info/Dokument/Strategjia%20za%20integraciju%20albanske%20manjine%20predlog.pdf>.
 - Konferenca 'Aspektet e sigurisë për normalizimin e marrëdhënieve Beograd-Prishtinë-Tiranë', fjalimi i shefit të Drejtorisë Koordinuese për Kosovë dhe Rrafsh të Dukagjinit i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Slavisha Arsenijeviq, Beograd, më 27 qershor 2014
 - Departamenti i SHBA-ve [2013] Serbia 2012 Raport për të drejtat e njeriut.
 - Grupi i Bankës Botërore, Përmbledhje e shkurtër e programit të partneritetit në Serbi, linku: <http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Serbia-Snapshot.pdf>, prill 2014.

Intervistat:

- Abdullah Ahmeti, përfaqësues i shoqërisë civile, Preshevë, më 28 shkurt 2014.
- Belgzim Kamberi, Këshilli për të Drejtat e Njeriut, Preshevë, më 27 shkurt 2014.
- Dragan Popoviq, Qendra e Politikave, Beograd, më 21 shkurt 2014.
- Anëtar i Misionit të OSBE në Serbi, Beograd, më 25 shkurt 2014.
- Struktura etnike e popullsisë, punëtorëve dhe e shefave të institucioneve dhe e bizneseve në komunën e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, Këshilli për të Drejtat e Njeriut, të dhënat për 2010/2011, 2011
- Galip Beqiri, Këshilli Kombëtar Shqiptar, Bujanoc, më 27 shkurt 2014.
- Ivana Stielja, YUCOM, Beograd, më 26 shkurt 2014.
- Milica Kostiq, Fondi për të Drejtën Humanitare, Beograd, më 6 mars 2014.
- Milica Rodiq, Trupi Koordinues për MPB, Beograd, më 24 shkurt 2014.
- Nevena Petrushiç, Komisionere për Mbrojtjen e Barazisë, Beograd, më 26 shkurt 2014.
- Policia në pozitë udhëheqëse, Policia e Serbisë, Preshevë, më 28 shkurt 2014.
- Polici i cili punon në polici 12 vjet, Policia e Serbisë, Bujanoc, më 27 shkurt 2014.
- Polici i cili punon në polici 12 vjet, Policia e Serbisë, Preshevë, më 28 shkurt 2014.
- Polici i cili punon në polici 12 vjet (pozita në hierarki), Policia e Serbisë, Preshevë, më 28 shkurt 2014.
- Polici i cili punon në polici për një vjet, Policia e Serbisë, Preshevë, më 28 shkurt 2014.
- Polici i cili punon në polici nga 1990, Policia e Serbisë, Preshevë, më 28 shkurt 2014.
- Përfaqësuesi i gazetës “Vranjske Novine”, Vranjë, më 28 shkurt 2014.
- Riza Halimi, president i Partisë Demokratike për Veprim, Kuvendi i Serbisë, Preshevë, më 27 shkurt 2014.
- Shaip Kamberi, ish-kryetar i komunës së Bujanocit, më 28 shkurt 2014.
- Tatjana Strahinjiç Nikoliç, Ndërtimi i paqes dhe zhvillimi lokal përfshirës, Intervistë me Skype Beograd, më 6 mars 2014.

PËR AUTORËT

Sofije KRYEZIU punon në QKSS që nga Nëntori i vitit 2010 në cilësinë e hulumtueses dhe koordinatores së projekteve të ndryshme në QKSS. Është autore dhe bashkautore e publikimeve të ndryshme të ndërlidhura me fushën e sigurisë. Ka përfunduar studimet Master për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në Universitetin e Biznesit dhe Teknologjisë. Ka fituar titullin Bachelor në Shkenca Politike, Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci me fokus të veçantë në Drejtësi, Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci në po të njëjtin universitet.

Isidora STAKIC ka fituar diplomë Bachelor në Marrëdhëniet Ndërkombëtare në Fakultetin e Shkencave Politike në Universitetin e Beogradit, dhe diplomë Masteri në të Drejtat e Njeriut në një program të Erasmus Mundus në bashkëpunim të tri universiteteve nga Britania e Madhe, Suedia dhe Norvegjia. Isidora iu bashkua BCSP në vitin 2012 në pozitën e hulumtuese e re. Interesat e saj hulumtuese përfshijnë: sigurinë rajonale dhe marrëdhëniet ndëretnike në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ekstremizmin e krahut të djathtë, të drejtat e minoriteteve, si dhe perspektivën gjinore në siguri.

RRETH ORGANIZATAVE

QENDRA KOSOVARE PËR STUDIME TË SIGURISË (QKSS) Kosova

Qendra për Studimet e Sigurisë në Kosovë (KCSS) është organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse këshilluese e themeluar më 2008 e cila si qëllim kryesor e ka zhvillimin e studimeve kërkimore në sektorin e sigurisë. KCSS realizon kërkime dhe organizon konferenca dhe seminare në fushat që kanë të bëjnë me politikat e sigurisë, sundim të ligjit, drejtësisë dhe vëzhgimit të sektorit të sigurisë. Aktivitetet e KCSS-së kontribuojnë në inkurajimin e vëzhgimit demokratik të institucioneve të sigurisë në Republikën e Kosovës.

QENDRA E BEOGRADIT PËR POLITIKA TË SIGURISË (QBPS) Serbia

Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë (QBPS) është një grup këshillues i pavarur i themeluar në vitin 1997 për avokim në siguri kombëtare dhe të njeriut e bazuar në demokraci dhe në respektimin e të drejtave të njeriut. QBPS punon për konsolidimin dhe reformën e sektorit të sigurisë (SSR) dhe për integrim të sigurisë së shteteve të Ballkanit Perëndimor në komunitetin Euro-Antlantik duke krijuar mjedis të politikave të sigurisë të bazuara në dijeni dhe inkuadrim. Këto qëllime i plotëson me kërkime, avokim publik, edukim, duke i bashkuar aktorët përkatës dhe rrjetëzim.

RRETH PROJEKTIT

Forumi Hulumtues i Sigurisë është një projekt i përbashkët në mes të tri qendrave të pavarura hulumtuese nga Beogradi (BCSP), Prishtina (QKSS) dhe Tirana (IDM) të specializuara në hulumtimin e çështjeve të sigurisë. Projekti ka për qëllim të nxisë debat të balancuar midis qendrave hulumtuese (think-tank), komunitetit akademik, politikës publike dhe medias, në mënyrë që të sigurojë zgjidhje alternative për sfidat e vazhdueshme të bashkëpunimit ndërmjet Serbisë, Kosovës dhe Shqipërisë.

